

Përmirësimi si Mësues i Ngjashëm me Krishtin – Një Vlerësim Vetjak

Si mësues, ne duhet t'i vlerësojmë rregullisht pikat tona të forta dhe dobësitë tona në mënyrë që t'i ndihmojmë nxënësit të ndërtojnë besim te Jezu Krishti dhe të bëhen më shumë si Ai. Veprimtaria në vijim mund t'ju ndihmojë të zbatoni parime të mësimdhënies si Krishti. Merreni parasysh se sa mirë ju përshkruan si mësues secili nga pohimet vijuese. Zgjidhni përgjigjen më të përshtatshme për secilin pohim: 1) rrallë, 2) nganjëherë, 3) shpesh, 4) pothuajse gjithmonë.

Më pas, sikurse të udhërrëfoheni nga Shpirti, me lutje përzgjidhni disa gjëra që do të donit t'i përmirësonit. Vendosni disa synime dhe përdoreni këtë burim që t'ju ndihmojë të përmirësoheni.

Përqendrohuni te Jezu Krishti

- ☐ Jap mësim rreth Jezu Krishtit pavarësisht nga ajo që po jap mësim.
- ☐ E theksoj shembullin e Jezu Krishtit.
- ☐ I ndihmoj nxënësit ta njohin dashurinë, fuqinë dhe mëshirën e Zotit në jetën e tyre.
- ☐ I ndihmoj nxënësit ta forcojnë marrëdhënien e tyre me Atin Qjellor dhe Jezu Krishtin.
- ☐ I ndihmoj nxënësit të përqipen në mënyrë të qëllimtë që të jenë më shumë si Jezu Krishti.

Duajini Ata të Cilëve u Jepni Mësim

- ☐ Përqipem t'i shoh nxënësit në mënyrën që i sheh Perëndia.
- ☐ Kërkoj t'i njoh ata të cilëve u jap mësim, t'i kuptoj rrethanat, nevojat dhe pikat e tyre të forta.
- ☐ Lutem për nxënësit me emra.
- ☐ Krijoj një mjedis të sigurt ku të gjithë respektohen dhe e dinë se kontributet e tyre vlerësohen.
- ☐ Gjej mënyra të përshtatshme për ta shprehur dashurinë time.

Jepni Mësim me Anë të Shpirtit

- ☐ E përgatit veten shpirtërisht për të dhënë mësim.
- ☐ U përgjigjem nxitjeve shpirtërore rreth nevojave të nxënësve.
- ☐ Krijoj mjedise dhe mundësi që nxënësit të marrin mësim nga Fryma e Shenjtë.
- ☐ I ndihmoj nxënësit ta kërkojnë, ta dallojnë dhe të veprojnë sipas zbulesës vetjake.
- ☐ Jap dëshmi shpesh dhe i inkurajoj nxënësit të tregojnë ndjenjat, përvojat dhe dëshmitë e tyre.

Jepeni Mësim Doktrinën

- ☐ E mësoj për veten time doktrinën e Jezu Krishtit.
- ☐ Jap mësim nga shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve të ditëve të mëvonshme.
- ☐ I ndihmoj nxënësit t'i kërkojnë, dallojnë dhe kuptojnë të vërtetat në shkrimet e shenjta.
- ☐ Përqendrohem tek të vërtetat që të çojnë drejt kthimit në besim dhe ndërtojnë besim te Jezu Krishti.
- ☐ I ndihmoj nxënësit të gjejnë lidhje me rrethanat vetjake të doktrina e Jezu Krishtit.

Ftojini të Mësuarit me Zell

- ☐ I ndihmoj nxënësit të marrin përgjegjësi për të mësuarit.
- ☐ I inkurajoj nxënësit të arrijnë ta njohin Shpëtimtarin me anë të studimit të përditshëm të ungjillit.
- ☐ I ftoj nxënësit të përgatiten të mësojnë.
- ☐ I inkurajoj nxënësit të tregojnë të vërtetat që po mësojnë.
- ☐ I ftoj nxënësit ta jetojnë atë që po mësojnë.